

Udhëzues për aplikantët për EDIH dhe pyetjet më të shpeshta

Për çfarë shërben ky udhëzues:

Ky dokument shërben si udhëzues për "Procesin Kombëtar të Para-Përzgjedhjes për EDIH në Shqipëri". Procesi i para -përzgjedhjes, synon të identifikojë dhe përzgjedhë kandidatët (subjekte individuale ose konsorciume) deri në datën 22 Janar 2024. Subjektet candidate të përzgjedhura në këtë fazë, do të kualifikohen më pas për të aplikuar në "Thirrjen për Propozim për Rrjetin e Qendrave Evropiane të Inovacionit Digjital – Shqipëri", që do të hapë Komisioni Evropian (KE) në Dhjetor 2023, dhe që financohet në kuadër të Programit të Evropës Digjitale.

Udhëzuesi ofron përgjigje për pyetjet më të shpeshta në lidhje me këtë proces dhe është hartuar nga një grup pune të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) me mbështetjen dhe në konsultim me projektin e BE-së për Inovacion të Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), konkretisht sipas planit të shumë donatorëve të EU4Innovation. Ky dokument nuk zëvendëson dokumentet zyrtare të KE-së për EDIH.

Për pyetje specifike lutemi kontaktoni në këtë adresë e-mail: dih@techspace.al;

Përmbajtja

1. Çfarë janë Qëndrat e Inovacionit Digjital Evropian (EDIHs)?	3
2. Ku mund të gjej më shumë informacion rreth EDIHs?	4
3. Cili është objektivi i Procesit Kombëtar Shqiptar të Para-Përzgjedhjes ?.....	5
4. Çfarë ka për subjektin apo konsorciumin tim?	5
5. A ka ndonjë kufizim ndaj sektorit, temës apo fokusit teknologjik të EDIH-së së propozuar?	6
6. Çfarë masash mbështetëse janë në dispozicion për palët e interesuara gjatë procesit kombëtar të para-përzgjedhjes dhe më tej?	6
7. Çfarë lloj organizatash mund të aplikojnë?	7
8. Cili është afati kohor i parashikuar për procesin e NSPP dhe çfarë ndodh më pas?	8
9. Si të aplikoj?	9
10. A mundet që aplikantët të jenë pjesë e më shumë se një konsorciumi?	9
11. Çfarë ndodh nëse nuk e dorëzoi kërkesën time brenda afatit?	10
12. Si do ta vlerësojmë aplikimin tuaj?	10
13. Ankesat	11
14. Dispozitat përfundimtare.....	11

1. Çfarë janë Qendrat e Inovacionit Digjital Evropian (EDIHs)?

Për shumë vite, Komisioni Evropian (KE) ka mbështetur nisma të ndryshme për të ndërlidhur më 3ire botën e kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë me biznesin, p.sh, duke nxitur infrastrukturën publike të teknologjisë dhe hulumtuesit me SME-të. Koncepti i “*Digital Innovation Hub*” (DIH) u publikua në vitin 2016, për të mbështetur bizneset në adoptimin e teknologjive dhe inovacioneve digjitale. Këto DIH filluan me një shumëllojshmëri të gjerë metodash dhe formash organizative. Qendrat Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH), janë zhvillimi i mëtejshëm i këtij koncepti. Ato i nënshtrohen një procesi të rreptë vlerësimi që gjithashtu i kushton vëmendje përhapjes rajonale, për të ofruar një spektër të plotë shërbimesh mbështetëse duke qenë pjesë e një rrjeti.

Një Qendër Evropiane e Inovacionit Digjital (EDIH), është një ent i vetëm ose një grup i koordinuar subjektsh me ekspertizë plotësuese dhe me objektiv jofitimprurës, për të mbështetur në një shkallë të gjerë transformimin digjital të (1) kompanive, veçanërisht SME-ve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe/ose (2) organizatave të sektorit publik që kryejnë veprimtari joekonomike. EDIH-të ofrojnë shërbime të tilla si testimin teknologjik para investimit, trajnimin dhe zhvillimin e aftësive, mbështetje për të gjetur investime si dhe rrjetëzim dhe akses në ekosistemet e inovacionit.

Një EDIH synon të mbështesë transformimin digjital të kompanive (veçanërisht SME-të, ndërmarrjet e vogla me kapital të mesëm¹) dhe/ose organizatat e sektorit publik në një shkallë të gjerë. Ai përbëhet nga një ose më shumë organizata që punojnë së bashku dhe plotësojnë ekspertizën e njëra-tjetrës.

Një EDIH duhet të shërbejë për një zonë të përcaktuar gjeografike, duke ofruar mbështetje për klientët brenda një zone që i lejon klientët të vizitojnë EDIH, brenda një kohe të arsyeshme udhëtimi (d.m.th. rreth 2 orë kohë udhëtimi në një drejtim). Prandaj, çdo EDIH duhet të ketë një fokus gjeografik².

Çdo EDIH duhet të ofrojë shërbime në fushat e mëposhtme:

- Testim para investimit: Të sigurojë lehtësira, infrastrukturë dhe mbështetje, për t'i mundësuar kompanive të testojnë teknologjitë digjitale në mënyrë që të marrin një vendim të informuar në lidhje me investimet në teknologjitë digjitale.
- Aftësitë dhe trajnimet: Të ofrojë shërbime dhe oferta për të përmirësuar aftësitë e fuqisë punëtore ekzistuese të klientëve, si dhe për të rritur kompetencat e përgjithshme në kompani dhe/ose organizata të sektorit publik dhe për të krijuar një perspektivë strategjike në pozicionet udhëheqëse të kompanisë në lidhje me transformimin digjital.
- Mbështetje për gjetjen e investimeve: Të ndihmojë kompanitë të gjejnë burime financimi për investimet e tyre të transformimit digjital, shërbimet e reja digjitale dhe modelet e biznesit.
- Rrjetëzimi dhe akses në ekosistemet e inovacionit: Të krijojë një rrjet mbështetëse në zonën e veprimit, si dhe të ndërtojë dhe sigurojë akses në ekosistemet përkatëse të inovacionit. EDIH-së do t'i duhet të krijojë një rrjet rajonal, të jetë pjesë e një rrjeti në mbarë Evropën dhe të sigurojë një shërbim me një ndalesë për klientët. Kjo përfshin në mënyrë të qartë rrjetëzimin me EDIH të tjera si dhe projekte të tjera të financuara nga Programi i Evropës Digjitale (DEP).

¹ Sipas përkufizimit të Komisionit të BE-së, një "Small Mid-cap" është një ndërmarrje me deri në 499 punonjës (shih FAQ: Qendrat Evropiane të Inovacionit Digjital: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/faq-european-digital-innovation-hubs>)

² Për më shumë info, shih Programin e Punës: <https://european-digital-innovation-hubs.ec.europa.eu/knowledge-hub/guidance-documents/edih-work-programme-2021-2023>

Një EDIH nuk ka nevojë të jetë funksionale me grupin e plotë të shërbimeve si më sipër që në fillim. Megjithatë, pritet që një EDIH gjatë 18 muajve të parë të funksionimit, të bëjë të disponueshëm grupin e plotë të shërbimeve dhe infrastrukturës plotësuese.

Çdo EDIH duhet të trajtojë një ose më shumë nga këto teknologji/fusha tematike:

- Përlllogaritje me performancë të lartë (High Performance Computing),
- Inteligjenca Artificiale,
- Siguria kibernetike,
- Aftësitë Digjitale të Avancuara.

Çdo EDIH duhet të ofrojë shërbime bazuar në një fokus/ekspertizë specifike, e cila do të mbështesë sektorin privat dhe publik vendas në transformimin e tyre digjital dhe të gjelbër. Ky specializim (i zgjuar) mund të forcohet me kalimin e kohës dhe duhet të përfitojë nga kompetencat ekzistuese lokale në këtë fushë. Shërbimet duhet të ofrohen mbi baza të hapura, transparente dhe jodiskriminuese. Çdo EDIH duhet të veprojë si një pikë aksesi në Rrjetin Evropian të EDIH-ve, duke ndihmuar kompanitë lokale dhe/ose aktorët publikë që të marrin mbështetje nga EDIH-të e tjera, kur kompetencat e kërkuara janë jashtë kompetencës së EDIH-së lokale, duke siguruar kështu që çdo palë e interesuar të marrë mbështetje të nevojshme kudo që është në dispozicion në Evropë. Në të kundërt, çdo EDIH duhet të mbështesë kompanitë dhe aktorët publikë nga rajone dhe vende të tjera të prezantuara nga EDIH të tjera që kanë nevojë për ekspertizën e tyre.

EDIH-të duhet të lidhen në mënyrë aktive me qendrat e tjera në Shqipëri dhe vende të tjera, të ndajnë praktikat më të mira dhe njohuritë e specializuara, të lidhin kompanitë me njëra tjetrën në fushën e tyre të veprimit dhe të kërkojnë sinergji me novatorët dhe adoptuesit e hershëm. Duke pasur parasysh natyrën evropiane dhe karakterin e rrjetëzimit të EDIH-ve, është shumë e rëndësishme që EDIH-të në Shqipëri të mund të komunikojnë në anglisht.

Çdo EDIH duhet të vërë në dispozicion pajisjet përkatëse të eksperimentimit që lidhen me specializimin e tij. SME-të, kompanitë e vogla me kapital të mesëm dhe sektori publik do të jenë në gjendje të testojnë teknologjitë e propozuara, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, ndikimin e tyre mjedisor dhe mundësinë e aplikimit të këtyre teknologjive në biznesin e tyre përpara se të investojnë më tej në to.

EDIH-të duhet të mbajnë marrëdhënie të strukturuar afatgjata me aktorët përkatës lokalë si autoritetet rajonale, grupimet industriale, shoqatat e SME-ve, bizneset dhe agjencitë e zhvillimit rajonal, inkubatorët, përsheptuesit dhe dhomat e tregtisë.

2. Ku mund të gjej më shumë informacion rreth EDIHs?

Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni informacionit të disponueshëm publikisht në faqen e internetit të KE-së por pa u kufizuar në:

- Në 7 hapa tek një (E)DIH: <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/handle/JRC121604>
- Pyetjet e bëra më shpesh, Qendrat Evropiane të Inovacionit Digjital, Versioni 5.9 – 2 Gusht 2023 <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/faq-european-digital-innovation-hubs>.
- Thirrja: DIGITAL-2023-EDIH-04 — Rrjetet e Qendrave të Inovacionit Digjital Evropian https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/digital/wp-call/2023/call-fiche_digital-2023-edih-04_en.pdf.

- Qendra e njohurive për Përsheptuesin e Transformimit Digjital <https://european-digital-innovation-hubs.ec.europa.eu/knowledge-hub>.
- Programi i punës EDIH: <https://european-digital-innovation-hubs.ec.europa.eu/knowledge-hub/guidance-documents/edih-work-programme-2021-2023>.

3. Cili është qëllimi dhe procedura e Procesit Kombëtar Shqiptar të Para-Përzgjedhjes ?

Qëllimi përfundimtar i Programit Digjital të Evropës është krijimi i Qendrave Evropiane të Inovacionit Digjital në vendet e asociuara si Shqipëria për të mbështetur transformimin digjital dhe të gjelbër të ndërmarrjeve dhe/ose organizatave të sektorit publik në Shqipëri.

Përzgjedhja e EDIH-ve do të ndjekë një proces me dy hapa: së pari, një Shprehje Interesi që i kërkohet Qeverisë Shqiptare për caktimin e subjekteve kandidatë përmes një Prosesi Kombëtar të Para-Përzgjedhjes dhe së dyti, KE do të nisë një Thirrje për Propozime që është hapur më 20 dhjetor 2023³. Thirrja për Propozime nga KE do të jetë e hapur vetëm për subjektet kandidatë të përcaktuara që janë përzgjedhur me sukses përmes procesit kombëtar të para-përzgjedhjes bazuar në rezultatin e aplikimit të tyre. Lista kombëtare e subjekteve shqiptare (individë ose konsorciume) e përzgjedhur paraprakisht do t'i komunikohet KE-së nga Qeveria e Shqipërisë deri në fund të Janarit 2024. Thirrja për Propozime synon të zgjerojë rrjetin e EDIH-ve ekzistuese në BE në vendet e asociuara si Shqipëria.

Institucioni publik që ka nënshkruar Marrëveshjen Kuadër të BE-së për zbatimin e Programit të Evropës Digjital në Shqipëri është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Në mënyrë që të ketë subjektet kandidatë të përcaktuara në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, MIE dhe AKSHI do të publikojë një thirrje të hapur për aplikime për të realizuar procesin kombëtar të para-përzgjedhjes duke identifikuar subjektet kandidatë (individë ose konsorciume) që kualifikohen për Thirrjen për Propozime nga KE. Kushtet e thirrjes së hapur do të bëhen publike në faqet e mëposhtme: www.infrastruktura.gov.al dhe akshi.gov.al.

Rezultatet e procesit kombëtar të para-përzgjedhjes do të jenë të disponueshme publikisht në faqen e internetit tre ditë pune pasi KE të marrë listën e plotë të fituesve të fazës së para-përzgjedhjes. Individët/konsorciumet e përzgjedhur në listën përfundimtare do të informohen përpara se KE të njoftohet. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën përfundimtare do të kenë të drejtë të paraqesin propozimet e tyre në Thirrjen për Propozime të KE-së "Rrjeti i Qendrave Evropiane të Inovacionit Digjital - Vendet e Asociuara".

4. Çfarë ka për subjektin/apo konsorciumin tim?

Mbështetje financiare

KE siguron një fond total prej një (1) milion € për EDIH në Shqipëri, në formën e granteve për një kohëzgjatje deri në katër (4) vjet (2024-2027). Grantet parashikohen të nënshkruhen në gjysmën e dytë të vitit 2024. Financimi nga KE për EDIH-të në Shqipëri do të mbulojë deri në 50% të buxhetit total të EDIH.

Pjesa e fondit prej 50% e buxhetit të parashikuar për EDIH duhet të plotësohet nga vetë kandidati EDIH (subjekti individual ose konsorcium). Referuar praktikës së BE-së, fondi shtesë prej 50% mund të sigurohen nga institucione publike, nëpërmjet sponsorizimeve - nga donatorë ndërkombëtarë - fonde të veta, të ardhura të krijuara nga EDIH ose të tjerë, si dhe një përzierje burimesh financimi. Është thelbësore të përmendet se 50% shtesë e buxhetit nga kandidati nuk ka nevojë të provohet menjëherë

³ <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/digital-2023-edih-04-associated?keywords=EDIH&tenders=false&openForSubmission=false&sortBy=title>

që nga fillimi i periudhës së grantit me KE-në, por vetëm me raportimin e parë, 18 muaj pas fillimit të grantit.

Ndërkohë nuk ka asnjë kufi të poshtëm ose të sipërm të vendosur nga KE për buxhetin për çdo EDIH përkatëse në Shqipëri, supozohet se EDIH-të në Shqipëri do të kenë një buxhet total (50% KE / 50% fonde të vetat) në intervalin – nga 400.000 EUR deri në 1.000.000 EUR. Një sondazh i mbajtur gjatë Forumit të Palëve të Interesit në Madrid (Nëntor 2019) vlerësoi shpërndarjen e kostove si më poshtë: 50-75% në kosto personeli, 10-25% në pajisje dhe 5-10% në kosto udhëtimi. Në Shqipëri, veçanërisht, pjesa e pajisjeve mund të jetë më e lartë. Të gjithë këta numra duhen parë si shembuj tregues. Çdo aplikant inkurajohet fuqimisht të bëjë llogaritjen e buxhetit të kërkuar dhe shpërndarjen e burimeve.

Një EDIH duhet të ketë një objektiv jofitimprurës; nëse një shoqëri tregtare është pjesë e një EDIH, ajo duhet të deklarojë se për aktivitetet e mbuluara nga granti i KE-së, të gjitha paratë e fituara ose të dhuruara për të do të përdoren për të ndjekur objektivat e EDIH dhe për ta mbajtur EDIH-në funksionale. Nëse të ardhurat janë pjesë e planit të financimit, këto duhet të ri-investohen në EDIH. Fitimet mund të jenë pjesë e planit për të bashkëfinancuar 50% të fondeve jashtë BE-së.

Mbështetje jo-financiare

Për masat mbështetëse gjatë fazës kombëtare të para-përzgjedhjes, ju lutemi kontrolloni seksionin 8.

GIZ Albania, si një organizatë partnere, do të ofrojë asistencë teknike (ndërtimin e kapaciteteve) për subjektet candidate të përcaktuara gjatë hartimit të propozimit për Thirrjen për Propozime të KE-së nga muaji Shkurt deri në Prill 2024. Përveç kësaj, do të ofrojë masa mbështetëse për EDIH-të e përzgjedhura gjatë fazës së zbatimit duke filluar nga Qershori 2024 (nëse fiton një aplikues) e në vazhdim për të forcuar më tej kapacitetet operacionale të EDIH-ve. Kjo do të përfshijë aktivitetet brenda rrjetit me EDIH-të ekzistuese. MIE dhe AKSHI do të ndihmojnë EDIH-të e përzgjedhura në përgatitjen dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje granti.

5. A ka ndonjë kufizim ndaj sektorit, tematikë apo fokusit teknologjik të EDIH-së së propozuar?

Nuk ka asnjë kufizim sepse procesi i përzgjedhjes është projektuar të jetë i lidhur me sektorin e teknologjisë, që do të thotë se MIE mirëpret aplikime nga çdo sektor, që kanë temë apo fokus teknologjinë, fusha e veprimtarisë në përputhje me Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022– 2026, Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021 – 2027.

Në BE, fokusi i teknologjisë është vendosur në Pëllogaritjet me Performancë të Lartë, Inteligjencën Artificiale, Sigurinë Kibernetike dhe Aftësitë Digjitale të Avancuara. Të paktën një nga këto fusha duhet të adresohet por mund të trajtohen edhe fusha të tjera.

Për një përmbledhje të EDIH-ve që funksionojnë dhe fokusit të tyre në teknologji dhe sektor, referojuni katalogut të EDIH-së⁴.

Duke pasur parasysh natyrën e rrrjeteve të EDIH-ve, palët e interesuara inkurajohen fuqimisht të kontaktojnë EDIH-të ekzistuese për të diskutuar idetë e tyre për EDIH-në e tyre përkatëse shqiptare.

6. Çfarë masash mbështetëse janë në dispozicion për palët e interesuara gjatë procesit kombëtar të para-përzgjedhjes dhe më tej?

Për të ndihmuar aplikantët në këtë proces, do të ofrohen disa shërbime mbështetëse:

⁴ https://european-digital-innovation-hubs.ec.europa.eu/edih-catalogue?f%5B0%5D=edih_soe%3Aedih&f%5B1%5D=edih_soe%3Asoe

(A) Webinare – “Informativ & Pyetje Përgjigje”:

Do të ofrohen webinarë " Informuese & Pyetje Përgjigje ". Ora dhe datat e sakta të këtyre webinarëve mund të gjenden në faqen e internetit <https://business.dii.gov.ua/digital-europe-programme> . Pjesëmarrësit mund të regjistrohen përmes Formularit të Regjistrimit, i cili do të vendoset në faqen e mësipërme të internetit. Pasi të regjistrohen, do të marrin një ftesë, duke përfshirë detajet e takimit. Webinarët “Informuese & Pyetje Përgjigje” do t'u ofrojnë palëve të interesuara mundësinë për të adresuar çështje të hapura dhe për të sqaruar pyetjet drejtpërdrejt me MIE dhe ekipin e GIZ. Webinarët do të mbahen në gjuhën angleze.

(B) Webinare - "Këshillues"

Aplikantët e interesuar mund të kenë akses në webinarë të regjistruara që janë organizuar nga Ministria e Transformimit Digjital të Ukrainës, ku së bashku me (GIZ) kanë zhvilluar të ashtuquajturat webinarë këshillues për aplikantët e mundshëm në Ukrainë, të cilat janë gjithashtu të vlefshme për aplikantët potencialë Shqiptarë dhe mund të gjenden në linkun <https://business.dii.gov.ua/edihs-vebinar>. Webinarët mbulojnë rastet e Polonisë, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Lituaniës, Letonisë, Spanjës, Sllovenisë, Kroacisë si dhe ato sektoriale (p.sh. Shëndeti). Gjithashtu, KE ka zhvilluar webinarë këshillues të cilat gjenden në link Webinar: <https://european-digital-innovation-hubs.ec.europa.eu/events/webinar-state-play-edih-network>

(C) Mbështetje me Zhvillimin e Propozimeve për KE-në Shkurt - Prill 2024

GIZ Albania do të ofrojë mbështetje teknike me zhvillimin e propozimeve të subjekteve kandidatë të caktuar pasi të ketë përfunduar procesi kombëtar i parazgjedhjes. Kjo do të sigurohet me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë të cilët do të kontraktohen nga GIZ Albania për të mbështetur kandidatët e caktuar me shkrimin e propozimeve.

(D) Mbështetje me funksionalizimin e EDIH-ve Shqiptare Qershor 2024 – Qershor 2025/26

Nëpërmjet ekspertizës ndërkombëtare, GIZ Albania do të ofrojë ngritjen e kapaciteteve për EDIH-të e përzgjedhura (Menaxhimin e Granteve, Modelin dhe Planin e Biznesit, Marketingun dhe Komunikimin, Rrjetëzimin, Vizitat studimore, etj.) për të forcuar më tej kapacitetet operacionale të EDIH-ve.

Pjesëmarrja në ndonjë nga pikat e përmendura më sipër nuk është e detyrueshme dhe në asnjë rrethanë, nuk do të çojë në përzgjedhjen automatike të aplikimit!

7. Çfarë lloj organizatash mund të aplikojnë?

Lista e organizatave të mundshme që të drejtojnë një EDIH individualisht ose si pjesë e një konsorciumi përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Organizatat e Kërkimit dhe/ose Teknologjisë,
- Qendrat e Teknologjisë dhe/ose Inovacionit,
- Parqet Shkencore, Teknologjike dhe/ose Inovacionit,
- Organizatat mbështetëse të sipërmarrjes (Inkubatorë, Akseleratorë, Investitorë, etj.),
- Organizatat mbështetëse të biznesit (Dhomat e Tregtisë, Shoqatat Sektoriale, OJQ, etj.),
- Kompanitë inovative / Ofruesit privatë të Teknologjisë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të fokusuara në teknologjinë më të avancuar (SME),

- Agjencitë dhe Organizatat e Zhvillimit (Ekonomike, Rajonale, SME, Zhvillimi Industrial dhe/ose Teknologjik),
- Fondacionet e Zhvillimit Teknologjik, Kërkimit dhe/ose Inovacionit,
- Universitetet/fakultetet dhe/ose qendrat kërkimore të bazuara në universitet/fakultet,
- Institutet e Formimit Profesional,
- Grupimet industriale, shoqatat/kompanitë e lidhura me IT,
- Organizata financuese/financiare publike ose private.

8. Cili është afati kohor i parashikuar për procesin kombëtar të para-përzgjedhjes dhe çfarë ndodh më pas?

Thirrja për aplikime për procesin kombëtar të para-përzgjedhjes hapet **më datë 22 Dhjetor 2023**. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data **22 Janar 2024**, ora 23:59:59.

Gjatë kësaj periudhe, një sërë shërbimesh mbështetëse janë në dispozicion të aplikantëve (shih seksionin 6).

Pas mbylljes së formularit të aplikimit, aplikimet e dorëzuara do të vlerësohen nga një grup ndërinstytucional pune me MIE dhe AKSHI, dhe aplikimet më premtuese do të përzgjidhen për një listë përfundimtare, e cila më pas do t'i dorëzohet Drejtorisë së Përgjithshme të KE-së për Rrjetet e Kominikimeve, Përmbytjen dhe Teknologjinë (DG CONNECT) (shih seksionin 12).

DG CONNECT do të hapë një Thirrje për Propozime për kandidatët e përzgjedhur në listën përfundimtare më **20 dhjetor 2023**. Kjo Thirrje për Propozime do të qëndrojë e hapur deri më **10 prill 2024**, gjatë së cilës aplikantët e para-përzgjedhur do të jenë në gjendje të përgatisin propozimet e tyre. Propozimet përfundimtare do të merren vetëm nga DG CONNECT. Institucionet shqiptare (MIE dhe AKSHI) nuk marrin propozimet e paraqitura dhe nuk përfshihen në procesin e përzgjedhjes së propozimeve. DG CONNECT do të jetë vetëm përgjegjëse për vlerësimin dhe përzgjedhjen e propozimeve fituese. Buxheti i përgjithshëm në dispozicion do të shpërndahet sipas buxheteve të treguara në propozime. Shpërndarja e buxhetit/granteve do të menaxhohet nga DG CONNECT, në bazë të së cilës kandidatët e përzgjedhur do të nënshkruajnë një marrëveshje granti. Informacione të mëtejshme mund të gjenden në portalin e tenderit të KE-së⁵.

Përveç mbështetjes financiare nga KE, EDIH-të e përzgjedhura mund të marrin ndihma të ndryshme mbështetëse për hartimin, zhvillimin dhe funksionimin e EDIH-së së tyre (shih seksionin 4).

Propozimet që nuk kualifikohen për financim në kuadër të Programit të Evropës Digjitale, por janë renditur mbi pragun (10 e lart), do të marrin – nga KE-ja – të ashtuquajturën vulë të ekselencës dhe do të inkurajohen të përdorin këtë gjë për të marrë fonde nga burime të tjera (p.sh. komuniteti ndërkombëtar i donatorëve, etj.)

Ju lutemi, mos kontaktoni me DG CONNECT gjatë fazës së procesin kombëtar të para-përzgjedhjes. Të gjitha pyetjet duhet të adresohen gjatë webinarëve me pyetje dhe përgjigje.

⁵ <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/digital-2023-edih-04-associated?keywords=EDIH&tenders=false&openForSubmission=false&sortBy=title> Ju lutemi kushtojni vëmendje të veçantë PDF-së në fund të faqes (https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/digital/wp-call/2023/call-fiche_digital-2023-edih-04_en.pdf)

9. Si të aplikoj?

Thirrja për aplikime në kuadër të procesit kombëtar të para-përzgjedhjes hapet më datë datë **22 Dhjetor 2023 dhe mbyllet më 22 Janar 2024, ora 23:59:59** (ora e Tiranës). Gjatë kësaj periudhe, aplikantët mund të dorëzojnë aplikimet e tyre përmes Formularit të Aplikimit të publikuar Online – i cili dërgohet në adresën dih@techspace.al brenda afatit të lartpërmendur. Formulari i aplikimit nënshkruhet nga koordinatori i projektit ose titullari i subjektit aplikues.

Aplikimet e paraqitura ndryshe nga formulari i dorëzimit në internet nuk do të konsiderohen të pranueshme.

Formulari i Aplikimit Online duhet të plotësohet me identifikim parësor të aplikantëve që do të thotë që aplikanti (udhëheqës) duhet të tregojë emrin e tij zyrtar si organizatë (emrin e partner-it kryesor të konsorciumit në rastin e aplikimit si konsorcium), emrin e shkurtër dhe të gjatë të Qendrës Evropiane të Inovacionit Digjital të propozuar, si dhe adresat e postës elektronike të personit kryesor të kontaktit, i cili do të përdoret për komunikim zyrtar.

Formulari i Aplikimit Online duhet të plotësohet duke ngarkuar dokumentet përkatëse, përkatësisht Formularin e Aplikimit në Anglisht, dokumentet mbështetëse dhe Marrëveshjen e nënshkruar të Partneritetit. Ju lutemi vini re se aplikimet do të vlerësohen në gjuhën angleze.

Të gjitha seksionet kanë udhëzime në lidhje me formatin dhe madhësinë e shkrimit të aplikimit që duhet të dorëzohen.

Formulari i Aplikimit është i kufizuar në 12 faqe (format A4, shkrimi Arial, madhësia 11 me hapësira teke), duhet të dorëzohet si dokument PDF dhe nuk mund të jetë më i madh se 2 MB.

Dokumentet mbështetëse (shih seksionin 13.a të këtij udhëzuesi) ngarkohen si një material i vetëm i zipuar, me formatin .zip ose .rar dhe me një madhësi maksimale prej 16 MB.

Marrëveshja e nënshkruar e partneritetit duhet të dorëzohet si një dokument PDF me një madhësi maksimale prej 2MB.

Formulari i Aplikimit ka nën-seksionet e mëposhtme: Rëndësia, Zbatimi dhe Ndikimi. Çdo seksion shpjegohet më në detaje në templatën e formularit të aplikimit.

Të gjitha seksionet e formularit të aplikimit janë të detyrueshme, përveç Marrëveshjes së Partneritetit, e cila është e detyrueshme vetëm për aplikimet e dorëzuara në emër të konsorciumeve.

Të gjitha seksionet e Formularit të Aplikimit duhet të plotësohen që aplikimi të jetë i pranueshëm. Informacioni i ofruar duhet të jetë i përditësuar, i vërtetë, i plotë dhe i qëndrueshëm, duke lejuar një vlerësim të plotë të aplikimit.

Për çdo aplikim të paraqitur, aplikanti i vetëm ose, përkatësisht, aplikanti kryesor i një konsorciumi vepron si kontakti kryesor. Aplikanti (udhëheqës) është përgjegjës për të siguruar dorëzimin në kohë të propozimeve. Dorëzimi i propozimeve mund të bëhet vetëm nga një përfaqësues i aplikantit kryesor për të shmangur aplikimet e dyfishta.

Një propozim mund të dorëzohet vetëm një herë. Çdo modifikim i propozimit pas dorëzimit është i pamundur dhe nuk do të merret në konsideratë. Prandaj ne i këshillojmë aplikantët që të shqyrtojnë plotësisht aplikimin e tyre dhe të përdorin listën e verifikime në formularin e aplikimit përpara dorëzimit.

10. A mundet që aplikantët të jenë pjesë e më shumë se një konsorciumi?

Aplikantët dhe partnerët e konsorciumit mund të jenë vetëm pjesë e një konsorciumi. Nëse një anëtar është pjesë e dy konsorciumeve, të dyja aplikimet përjashtohen automatikisht nga procesi i vlerësimit.

11. Çfarë ndodh nëse nuk e dorëzoi kërkesën time brenda afatit?

Aplikimet e marra pas afatit nuk do të pranohen. Ne inkurajojmë aplikantët të mos presin për të dorëzuar aplikimet e tyre ditën e afatit final. Mos respektimi i afatit të dorëzimit për çfarëdo arsye, duke përfshirë edhe rrethanat lehtësuese, do të rezultojë në refuzimin e aplikimit.

12. Si do ta vlerësojmë aplikimin tuaj?

Procesi i vlerësimit është transparent, i drejtë dhe i barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Për këtë Thirrje për aplikime sipas procesit kombëtar të para-përzgjedhjes, çdo aplikim kalon nëpër disa kontrolle, përkatësisht (a) kontrolli administrativ dhe fillestar i përshtatshmërisë dhe (b) kontrolli i cilësisë, të përshkruar më poshtë.

Kontrulli administrativ dhe fillestar i përshtatshmërisë do të bëhet nga MIE dhe grupi i pavarur i vlerësuesve/ekspertëve dhe do të përfshijë aspektet e mëposhtme:

- Përshtatshmëria e institucioneve aplikuese (shih seksionin 7)
- Plotësimi i saktë i aplikimit
- Kërkesa për dorëzimin e dokumenteve (shih seksionin 9)

Kontrulli i cilësisë kryhet nga një komision përzgjedhës me anëtarë të MIE dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit ku të paktën dy persona do të shqyrtojnë çdo aplikim.

Rezultati maksimal i çdo nënseksioni është deri në 5 pikë. Çdo aplikim do të vlerësohet sipas tre (3) seksioneve kryesore, me gjithsej 10 nënseksione/kritere:

- RELEVANCA

- o Objektivat,
- o Kontributi në objektivat, politikat dhe strategjitë rajonale dhe/ose kombëtare (Sinergjitë),
- o Koncepti i bashkëfinancimit.

- ZBATIMI

- o Maturimi dhe aktivitetet/shërbimet e parashikuara,
- o Plani i zbatimit dhe përdorimi efikas i burimeve,
- o Kapaciteti për të kryer punën e propozuar.

- NDIKIMI

- o Rezultatet e pritshme, rezultatet dhe ndikimet afatgjata,
- o Shpërndarja dhe komunikimi,
- o Konkurrueshmëria dhe përfitimet për ekosistemin lokal të inovacionit,
- o Qëndrueshmëria mjedisore dhe kontributi në objektivat e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane.

Vlerësuesit do të vlerësojnë çdo nënseksion në një shkallë nga 0 në 5:

- 0 = Propozimi dështon në adresimin e kriterit ose nuk mund të vlerësohet për shkak të informacionit të munguar ose të paplotë
- 1 = Dobët – kriteri është adresuar në mënyrë joadekuate ose ka dobësi serioze të qenësishme
- 2 = E drejtë – propozimi trajton gjerësisht kriterin, por ka dobësi të konsiderueshme
- 3 = Mjaftueshëm – propozimi e trajton mirë kriterin, por ka një sërë mangësish

- 4 = Mirë – propozimi trajton shumë mirë kriterin, por ka një numër të vogël mangësish
- 5 = Shkëlqyeshëm – propozimi trajton me sukses të gjitha aspektet përkatëse të kriterit. Çdo mangësi është e vogël.

Secili vlerësues do të prodhojë një Raport Vlerësimi Individual për aplikim. Rezultati përfundimtar i çdo aplikimi do të llogaritet si një mesatare e vlerësimeve individuale të dhëna nga vlerësuesit. Çdo propozim do të shqyrtohet nga të paktën dy vlerësues individualisht. Nëse ka një diferencë prej më shumë se 20 pikësh midis Raporteve të Vlerësimit Individual të këtyre dy vlerësuesve për një propozim përkatës, vlerësuesi i tretë do të bëjë një vlerësim shtesë të propozimit përkatës.

Komiteti përzgjedhës do të bëjë llogaritjen e rezultatit përfundimtar.

Të gjitha aplikimet që arrijnë rezultatin përfundimtar prej 80% të pikëve të mundshme do të përfshihen në listën përfundimtare.

13. Ankesat

Aplikantët janë të lutur të konsiderojnë se vlerësimet do të bëhen nga ekspertë të kualifikuar dhe të trajnuar dhe se nuk ka ndërhyrje në vlerësimin e tyre. Prandaj, ankesat lidhur me rezultatet e vlerësimit nuk do të merren parasysh përveç gabimeve të mundshme në vlerësimin e kriterëve të para automatike të përshtatshmërisë.

Aplikantët kanë tre (3) ditë pune për të paraqitur ankesa duke filluar nga dita pas dërgimit të komunikimit. Komiteti përzgjedhës do ta shqyrtojë ankesën brenda jo më shumë se shtatë ditëve kalendarike nga marrja e saj. Nëse kërkohet më shumë kohë për të vlerësuar ankesën, komisioni përzgjedhës do ta informojë aplikantin me email për zgjatjen. Ankesat anonime, si dhe ankesat me informacion jo të plotë, nuk do të shqyrtohen.

Megjithatë, nëse pas marrjes së rezultateve të njërit prej vlerësimeve, aplikanti konsideron se është kryer një shkelje pas marrjes së rezultateve të njërit prej fazave të vlerësimit (kur parashikohet) ai dërgon ankesën e tij në Anglisht duke dërguar një email në adresën ankesadih@techspace.al, duke përfshirë informacionin sim ë poshtë:

1. Detajet e kontaktit (përfshirë adresën e emailit ku do të dërgohet përgjigjja),
2. Objekti i ankesës,
3. Informacion dhe dëshmi në lidhje me shkeljen e supozuar.

14. Dispozitat përfundimtare

Legjislacioni Shqiptar do të rregullojë çdo çështje që nuk mbulohet nga ky udhëzues. Aplikantët janë të lutur të konsiderojnë se MIE dhe AKSHI bëjnë përpjekje maksimale për të mbajtur konfidenciale të gjitha të dhënat e ofruara, megjithatë për të shmangur dyshimin, aplikantët janë vetë përgjegjës për të treguar çdo informacion konfidencial si të tillë. Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale do të mbetet pronë e aplikantëve.

Dhënia e të dhënave është vullnetare, edhe pse është e nevojshme për të marrë pjesë në Thirrjen për Aplikime. Pa dhënë të dhënat tuaja, kontaktimi me ju dhe vlerësimi i aplikimit bëhet i pamundur.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi na kontaktoni në: dih@techspace.al.

KE mund të anulohet thirrjen në çdo kohë, të ndryshojë dispozitat e saj ose ta zgjasë atë. Në një rast të tillë, MIE dhe AKSHI do të informojë të gjithë aplikantët për këto ndryshime.